



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, <http://www.gjilani-komuna.org/>, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

Nga seanca e **III (tretë)** të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 29.3.2012

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1 Raporti financiar për vitin fiskal 2011,
 - 2.2 Propozim-vendimi për shpalljen e Partneritetit publiko-privat: Lokacioni të "Magjistrallja",
 - 2.3 Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike për ndërtimin e objektit të Agjencionit të Inteligjencës së Kosovës në Gjiçan,
 - 2.4 Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të hapësirës përbrenda Kompleksit të shkollave të mesme,
 - 2.5 Studimi i arsyeshmërisë së PPP -Rregullimi i infrastrukturës të Kompleksit të shkollave të mesme të Gjiçanit
 - 2.6 Shqyrtimi i Draft kontratës për PPP të KRM "Higjiena"
 - 2.7 Propozim vendimi për largimin e mbetjeve nga ish Lapidari në fshatin Zhegër,
 - 2.8 Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P- 70403013-00635-7, me sipërfaqe prej 370 m², ZK-Gjiçan.
 - 2.9 Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes të pronarëve: Zyrafete Korqa-Xhevat Selimi dhe KK-Gjiçan,
 - 2.10 Propozim vendimi për ndryshimin Rregullores për taksat, ngarkesa dhe gjoha komunale,
 - 2.11 Propozim vendimi për ndarjen e bursave për student,
 - 2.12 Shqyrtimi i Kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale të arsimtarëve të cilat kanë kandiduar në zgjedhjet lokale të vitit 2007.
3. **Të ndryshme,**

Seanca i filloi punimet në ora 12.15 min

Kryesuesi i Seancës

- Izmi Zeka

Në punimet e Seancës së dytë morën pjesë :
Anëtarët e Kuvendit,
Kryetari i Komunës,
Drejtorët e drejtorive,
Përfaqësuesit e OSB-së
Njësia për Mbrojtjen e te Drejtave të Njeriut
Forumi Demokratik ‘Anamorava’
Mediet

Si zakonisht seancën e tretë të Kuvendit të Komunës e hapi zv/kryesuesi i Kuvendit Selim Selimi, sepse kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka për disa arsyeje zyrtar nuk ishte në fillim të seancës i cili erdhi në fillim të pikës së dytë të rendit të punës. Z Selimi fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë.

1. Me kërkesë të zv/kryesuesit të Kuvendit, z. Selim Selmi sekretaria konstatoi se në punimet e kësaj seance ishin të pranishëm 40 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi Ibish Ibishi.

Pasi që kishte kuorum për të vazhduar me punë kryesuesi kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se a pajtohen me rendin e punës?

Arben Mehmeti- sa i përket pikave të rendit të punës, përveç jo seriozitetit të kryesuesit të Kuvendit i cili nuk është i pranishëm në seancë i cili është edhe një akt i veçantë, sepse seanca e Kuvendit ka qenë desh të fillojë në ora 10, por ajo është shtyrë për ora 12 për t’ ia shtyrë agjendën kryesuesit në Prishtinë, por edhe tash në ora 12 përsëri vonohet dhe ne si Kuvend biem në pozicion të palakmueshëm!

Është mirë t’ i tërhiqet vërejtja seriozisht dhe duhet shqyrtuar edhe pozicionin e tij si kryesues, sepse kështu po maltretohet Kuvendi.

Sa i përket rendit të punës në emër të grupit të anëtarëve të grupit të LDK-së kërkojmë që për seancë të sotme ta kemi vetëm një pikë të rendit të punës. Kjo pikë të jetë; raporti financiar për vitin 2011.

Këtë po e them, sepse ky raport ka një rëndësi të madhe por edhe për shkak të një jo serioziteti të një qeverisje lokale që në minutat e fundit e bie këtë raport për ta aprovuar në Kuvend. Ky është një dokument për të cilin duhet të debatohet shumë në Kuvend dhe nuk është kohë e mjaftueshme për t’ iu qas seriozisht këtij raporti.

Sokol Haziri- për të mos i përsërit ato çka i tha Arbeni edhe AAK përafërsisht e ka të njëjtin qëndrim, duke pasur parasysh rëndësinë që e ka një raport vjetor financiar në të cilin duhet të sqarohet e tërë rrjedha e parasë publike dhe buxhetit të Komunës, mendoj që nuk është hapësirë e mjaftueshme të futen kaq shumë pika në rend të punës dhe të minimizohet çështja. Për këtë arsye edhe ne kërkojmë që raporti financiar të jetë e vetmja pikë e rendit të punës, kurse për pikat e tjera të debatojmë në takimet e tjera të radhës.

Mandej ka edhe vërejtje tjera e sidomos rreth asaj se si shpërndahet materiali për seancë dhe natyrisht sekretaria ka për obligim që 7 ditë para seancës që të gjitha çështjet dhe materialet të na i dërgojë. Ky është qëndrimi i ynë, por nëse ka nevojë ne mund bëjmë një pushim të shkurtër për t’ u marrë vesh?

Ramiz Ramadani- unë pajtohem plotësisht me shefin e grupit parlamentar të LDK-së dhe AAK-së që sot si pikë e veçantë të jetë raporti financiar, por kam një kërkesën të banorëve të fshatit Llashticë e cila është e një natyre urgjente, andaj kërkoj që të futet në rend të punës. Unë këtë kërkesë e cila ka të bëjë me gjendjen e alarmante të ambulancës në këtë fshat e të cilën ia kam dorëzuar me shkrim, kryetarit, kryesuesit dhe Kuvendi, mendoj se për një kohë të shkurtër ka mundësi për ta alarmuar këtë çështje?

Bahrie Veseli – dhe unë kam një kërkesë nga banorët e lagjes sime për ta asfaltuar rrugën “Gazmend Zajmi” dhe për ta rregulluar tërë infrastrukturën në këtë rrugë, sepse është në tërësi e degraduar.

Kërkoj që edhe kjo çështje të hyjë në rend të punës!

Arben Maliqi- z. zv/kryesues, unë kërkoj që të na i mundësoni 5 minuta pushim për ta bërë një konsultim, shefat e grupeve parlamentare dhe të merremi vesh lidhur me rendin e punës.

Arianit Sllamniku- unë së pari kërkoj që në shenjë te nderimit dhe respektimit të gazetarit të ndjerë Petrit Sherifi, ne si përfaqësuese të popullit ta respektojmë punën dhe kontributin e këtij gazetari me një minutë heshtje.

Nën dy kam një propozim dhe në emër të grupit propozoj që të shqyrtohet dukuria e mbulesës së femrave të cilat paraqiten në këtë formë jashtë institucioneve arsimore.

Kjo është një temë e cila ka të bëjë edhe me pikën 5 dhe është një temë e cila nuk duhet të anashkalohet ashtu lehtë. Prandaj propozoj që të jetë një pikë e veçantë.

Pas këtyre propozimeve në seancë erdhi edhe kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili propozoi 5 minuta pauzë për t’u dakorduar shefat e grupeve parlamentare lidhur me rendin e punës.

Izmi Zeka- ne gjatë pauzës përsëri nuk arritëm që të dakordohemi, sepse unë kam propozuar që sot t’i shqyrtojmë 6 pikat e para, por opozita me ngulm kërkon që sot të debatohet vetëm për pikën e parë.

Ne po vazhdojmë deri te pika 2.6, sepse janë më urgjente dhe nuk mund t’i shtyjmë më tutje, sepse edhe kanë qenë rekomandim i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ne këtë propozim e kemi bërë bashkërisht dhe kjo nuk është bërë njëanshëm.

Arben Maliqi-është fakt se nuk arritëm një koncenzues, por unë edhe njëherë i kisha lut këshilltarët që mos të debatojmë deri tek 2.6, por deri tek 2.5, sepse për mendimin tim këto janë disa pika të rendit të punës me shumë rëndësi dhe duhet t’i kalojmë.

Propozoj që nga pika 2.6 e më tutje t’i lëmë për seancën tjetër.

Sadudin Berisha- pozicioni i ynë është i qartë, sepse ne kemi llogaritur se seanca duhet të fillojë në ora 10, kurse ne ka tri orë që i kemi humbur kot. Ka ndodhur dhe po ndodh që raportet financiare të çdo niveli kur diskutohen në Kuvend të jenë të vetmet pika të rendit të punës. Është e vërtetë se ne në parim jemi pajtuar që të jetë ky rend i punës dhe nuk jemi për ta lëshuar seancën, po qe se raportohet vetëm për raportin financiar. Është një raport njëvjeçar, një punë njëvjeçare dhe është në interes të kryetarit dhe

kryesuesit të Komunës që opozita të jetë pjesë e debatit kur flitet për raportin financiar të vitit 2011.

Unë iu lus që të keni konsideratën që sot të jetë për debat vetëm pika e parë, në mënyrë që sot një javë apo ndonjë ditë tjetër të debatohet për pikat e tjera të punës.

Jemi të interesuar për të qenë këtu dhe të diskutohet vetëm pika e parë e rendit të punës, në të kundërtën konsiderojmë se nuk do të ketë hapësirë dhe kohë për të diskutuar për raportin në nivelin të cilin e kërkon ky raport.

Tefik Ibrahim- unë dua vetëm një sqarim? Cili ka qenë qëndrimi në Komitetin për Politikë dhe Financa i përfaqësuesve të LDK-së dhe AAK-së? Nëse ata e kanë dhënë pëlqim atje, pse në Kuvend sillen ndryshe?

Sipas kryesuesit pëlqimi është dhënë në Komitet, prandaj po pyes pse kanë tjetër sjellje në komitet, kurse krejt tjetër në seancë?

Arben Mehmeti- këtu u përmenden kamerat, por ato i kemi në shërbim të pushtetit!

Kjo është evidente nga TV “VALI”, sepse janë disa raste të cilat nuk do të duhej të janë ashtu, sepse ky medium duhet t’i shërbejë të gjitha grupeve politike njëjtë, mirëpo fjalimet e LDK-së dhe AAK-së shpeshherë cungohen, por edhe një pjesë e aktiviteteve të Komunës.

Është mirë që edhe TV “VALI” dhe mediumet e tjera dhe gazetarët, nëse i marrin informatat nga Zyra për Informim që i bënë Komuna e Gjiçanit edhe ato gazeta i bëjnë publike për gazetatat e tyre. Është mirë që edhe ato mjete të informimit të shkruara dhe elektronike të jenë këtu dhe ta përcjellin në mënyrë objektive, punën e secilit grup dhe në mënyrë objektive ta pasqyrojnë punën.

Disa gazetarë vetëm i marrin informatat nga Zyra për Informim dhe atë informatë e bëjnë pjesë të raportit të punës.

Po i them përfaqësuesit të AAK-së se në Komitetin për Politikë dhe Financa, përfaqësuesi i LDK-së ka qenë kundër një numri kaq të madh të pikave për të hyrë në debat të seancës!

Sokol Haziri- unë mendoj se qoftë marrëveshjet, qoftë mosmarrëveshjet duhet të zbatohen! Ne kërkuam pauzë prej 5 minutave dhe realisht nuk u morëm vesh? Debatit për këtë çështje rishtas, mua më duket humbje kot e kohës.

Ndërsa sa i përket TV “VALIT”, unë i shpreh “përgëzimet më të sinqerta” për punën tepër të mirë që po e bën në shërbim të pozitës dhe nuk do ta quaja TV i pavarur, por TV shumë, shumë i varur dhe le të vazhdojë si i tillë?

Izmi Zeka- ju po harroni se pozita është pushtet (pushteti është mane). Mirëpo për hir të korrektesisë dhe për hir të asaj që është vullneti për të debatuar vetëm për raportin dhe për hir të asaj që ne kemi marrë një çmim për transparencë dhe për tejkalim të hyrave vetanake, prandaj i përgëzoj edhe drejtoritë dhe opozitën për një angazhim konsistent që e kemi marrë këtë çmim.

Prandaj propozoj që të debatojmë vetëm për pikën e parë.

Sabedin Kadriu- i falënderoj së pari qytetarët, sepse ata i kanë dhënë këto mjete vetanake dhe mos të harrojmë se këshilltarë janë 41, kurse Gjilani i ka 100 mijë banorë!

I falënderojmë ata qytetarë!

Izmi Zeka- unë e thash Komuna e Gjilanit dhe me këtë kuptohet qytetarët! Kjo është mirënjohje për qytetarët e Gjilanit, për kryetarin e Komunës etj.

Unë propozoj që të deklaroheni se kush është që të debatojmë vetëm për raportin financiar, por të jetë e qartë se seanca tjetër është vazhdim!

Sadudin Berisha- ne jemi që seanca tjetër të jetë seancë e radhës në të cilën do të bisedojmë me rendin e sotëm të punës, por eventualisht me ndonjë plotësim nëse ka.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të rendit të punës vetëm me një pikë; raporti financiar për vitin 2011?

Aprovohet rendi i punës; raporti financiar për vitin fiskal 2011 me 37 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 3 ishin kundër.

Seanca vazhdon më 4 prill ora 10.

Procesverbali-

Nuk pati vërejtje në procesverbal i cili edhe aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1 Raporti financiar për vitin fiskal 2011

Izmi Zeka- përkritazi me pikën e dytë të rendit të punës fjalën do ta ketë drejtori për Financa i cili do të na jap sqarime më detale.

Nuhi Nuhiu- pas një përshëndetje që iu a bërë të gjithë të pranishmeve në seancë, drejtori i Financave, z. Nuhiu theksoi se ky është një raport i cili në mënyrën shumë detale është përgatitur nga zyrtarët e Drejtorisë për Financa. Duhet ta keni shumë të qartë se këtu çdo gjë është transparente dhe në çdo kohë mund të informoheni për çdo shpenzim dhe çdo të dalë nga buxheti Komunal. Për këto gjëra ne e kemi marrë çmimin si Komunë transparente, sepse kemi punuar në mënyrë të tillë, por jemi dalluar edhe me të hyra vetanake në të cilat kemi pasur edhe tejkalim të hyrave.

Viti buxhetor 2011 ke qenë një vit i cili ka pasur mjaft vështirësi për shkak të problemeve që janë shkaktuar me decentralizim, si janë Komunë e Parteshit, Artnaës etj.

Ky buxhet prej mbi 17 milion e 500 mijë eurove si buxhet fillestar, prej të cilave nga grandit i përgjithshëm i kemi pasur mbi 14 milion e 500 mijë euro, kurse të hyra vetanke i kemi pasur 3 milion të planifikuara.

Mirëpo gjatë punës së bashku me vullnetin dhe meritën e qytetarëve të hyrat vetanke janë rrit në 5 qind mijë euro, por edhe grandit qeveritar i cili ka qenë i dedikuar për çështjen e pagave dhe mëditjeve(për rritje të pagave në arsim).

Sa për njoftim po theksoj se nganjëherë në mjete të informimit thuhet se më shumë mjete por harxhojmë për mallra dhe shërbime se sa për investime kapitale!

Në vijim të fjalës së tij drejtori filloi për t' i dhënë sqarimet në detale sipas shifrave dhe të dhënave në raport të cilin raport anëtarët e Kuvendit e kanë marrë me kohë.

Në fund të fjalës së tij drejtori i Financave theksoi se çdo këshilltarë që është i interesuar për çdo shpenzim që është bërë mund të bëjë kërkesë për të kërkuar sqarime, kurse ne jemi përherë të përgatitur për të dhënë përgjigje.

Arben Mehmeti- për këtë raport ne kemi debatuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa në të cilin takim i kemi pasur vërejtjet tona e të cilat vërejte kanë qenë të shpenzimet, sepse nuk janë të specifikuara. Edhe në komitet ne zyrtarisht kemi kërkuar që të na ofrohet një specifikacion i caktuar për të kodin e mallrave dhe shërbimeve, mandej për subvencione, investime kapitale, shpenzime komunale dhe shpenzime të tjera të cilat duhet të na ofrohen hollësisht. Drejtori theksoi se këto gjëra i ka të gjitha, por pritet që ne të bëjmë kërkesë për të na dhënë përgjigje, por ato gjëra që diskutohen në Kuvend, në Komitet për Politikë dhe Financa dhe në komitete të tjera dhe nëse me një trup të KK-së bëhet një kërkesë e caktuar, nuk duhet as drejtori i drejtorisë, as kryetari i Komunës, as kryesuesi të pres shkresa me shkrim për të dhënë informata të caktuara, sepse është obligim i drejtorëve për t' i specifikuar të gjitha shpenzimet të cilat janë paraparë.

Është obligim i joni si këshilltarë komunal për ta ditur se në çfarë mënyre është harxhuar paraja e kontribut dhënësve.

Ne kemi pasur kërkesë deri më tash në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe deri më tash nuk është bërë asnjë veprim në ofrimin e dokumentacionit të nevojshëm për të pas të qartë çdo pozicion këtu. Mirëpo ne si LDK i kemi bërë edhe disa kërkesa të tjera disa drejtorëve e që ende nuk i kemi marrë përgjigjet lidhur me çështjet e caktuara.

Mirëpo tash e tutje e përkujtojmë, kryetarin e Komunës, kryesuesin dhe drejtorët e drejtorëve që çdo kërkesë që e drejtojmë në drejtori përkatëse nëse nuk e marrim përgjigjen zyrtare, jemi të detyruar që kërkesat t' i adresojmë në organet e tjera të cilat merren me sundimin e ligjit dhe mbrojtje të ligjit. Ne do të tentojmë që përmes atyre mekanizmave t' i marrim informatat e caktuara.

Konkretisht e kemi Drejtorinë e Bujqësisë së cilës i kemi bërë tri kërkesa, por deri më tash nuk e kemi marrë asnjë përgjigje.

Ju po krenoheni se keni marrë çmime për transparencë, por këtu nuk ka transparencë dhe ata që e kanë dhënë këtë transparencë duhet ta rishqyrtojnë këtë çmim, sepse nuk e kanë të bazuar në argumente, por janë bazuar në thënie të njerëzve të cilët nuk janë pjesë e këtij Kuvendi. Ne do të kishim pasur dëshirë që të jetë ashtu, por në praktikë nuk ka ndodh kështu?

Po e përkujtoj edhe njëherë drejtorin e Financave dhe kërkoj edhe njëherë në emër të LDK-së që të gjitha shpenzimet që janë në këtë material si janë ato për mallra dhe shërbime të specifikohen veç e veç. Të jenë me emër dhe mbiemër secili që ka përfutur në mënyra të ndryshme nga financat e KK në Gjilan.

Subvencione, dreka zyrtare të specifikohet kush ka ngrënë, cili këshilltarë kur dhe ku ka ngrënë? Në emër të LDK-së po e them se nëse nuk i marrim informatat e nevojshme ashtu si po i kërkojmë zyrtarisht jemi të detyruar pa vullnetin tonë, jemi të detyruar t' i drejtohem organëve të tjera për të na i siguruar ato informacione dhe këto kërkesa nuk mund të presin deri në pakufi.

Unë jam i mendimit se disa nga drejtorët e konsiderojnë trimëri (guxim) nëse nuk i përgjigjet LDK-së në këtë rast dhe para partisë së vet krenohet se nuk i kthen përgjigje LDK-së, sepse nuk i jep llogari asaj. Mirëpo këtu është e kundërta, sepse secili nga drejtorët e ka për obligim të jap përgjigje në pyetjet e grupeve parlamentare.

Te raporti financiar edhe njëherë drejtorit i bëj thirrje që të specifikohet në mënyrë të hollësishme çdo shpenzim financiar në Komunë. Nuk është mirë të priten kërkesat me shkrim për këto gjëra për të cilat po flasim dhe po i kërkojmë zyrtarisht këtu.

Këtu përfshihen edhe projektet, sa projekte janë kur janë nënshkruar, sa ka qenë afati kohor, sa ka qenë shuma, sa mjete janë harxhuar, kush e bartë përgjegjësinë për mos realizim të atyre projekteve, cilat janë organet mbikëqyrës etj?

Këto kërkesa neve na japin një bazë për ta shqyrtuar secilin dokument të rëndësishëm të këtij Kuvendi dhe në çastin kur e shohim se ka parregullsi dhe ka shkelje të ligjit, janë organet e tjera të cilat duhet të merren me këto çështje.

Sokol Haziri- unë shpresoj se ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me fleksibilitet të cilin e kemi pas gjer më tani dhe do të dëshiroja që t' i ruajmë këto raporte dhe këtë kulturë politike të cilën e kemi kultivuar qysh me kohë. Prandaj nuk duhet askush të na mbajë leksione se si duhet të sillemi, sepse ne jemi të zgjedhurit e popullit dhe vetëm ata kanë të drejtë të na korrigjojnë dhe këshillojnë dhe jo dikush tjetër.

Duhet kuptuar qëllimin tonë fleksibil, sepse ne duam që të kemi një klimë të mirë politike në Gjilan.

Sa i përket raportit financiar unë e përgëzoj drejtorin për këtë raport dhe e falënderoj për këtë punë dhe përpjekjet e tij kanë qenë që ta paraqesin në mënyrë sa më pozitive duke dhënë sqarime se si është shpenzuar paraja publike.

Mirëpo ne si AAK i kemi vërejtjet tona parimore për atë se ky buxhet ka qenë buxhet shpenzues i shpenzuar në vija të tjera dhe jo në vija esenciale të zhvillimit. Mua po më brengos ajo që vazhdimisht jemi pajtuar në atë pikën se grandet Qeveritare për Komunën e Gjilanit kanë qenë të pamjaftueshme dhe krejtësisht të vogla. Mirëpo për çudi sot e dëgjova se kryetari qenka pjesë e kësaj trupe, prandaj unë e përgëzoj këtë akt dhe do të jetë mirë që të angazhohet që grandet qeveritare të jenë të adresuara edhe në Komunë të Gjilanit, sepse edhe qytetarët tanë janë taksa pagues.

Çështja tjetër që shkalla e shpenzimit është e kënaqshme, por çështja tjetër e cila duhet të jetë më sqaruese është ajo e borxheve të cilat kanë mbetur! Cili është afati ligjor në bazë të të cilit do të kryhen këto pagesa ndaj borxhlinjve? Është një çështje që qytetarët duhet ta dinë se si obligimet e bartura si do të paguhen tash me buxhetin e këtij viti?

Parimisht këto janë gjëra të cilat ne e kemi vërejt dhe kërkojmë sqarime shtesë gjatë debati, sepse kjo nuk është për interes timin personal, por për interes të qytetarëve.

Izmi Zeka- këtu e keni një buletin të vogël për investime kapitale në të cilin janë të pasqyruar tërë investimet kapitale për 4 vite në vlerë prej mbi 74 milion euro?

Ejup Haziri-në emër të grupit parlamentar të PDK-së e mbështesim raportin financiar të cilin e ka paraqit drejtori i cili ka hartuar me profesionalizëm e pastaj e ka sjell në Kuvend. Në emër të grupit e mbështesim.

Arben Maliqi- unë në emër tim dhe grupit tim fillimisht e falënderoj TV “VALIN” për punën që është duke e bërë dhe po bën një punë serioze. Është fakt se çdo institucion është pak më bashkëpunues me pozitën, por nuk qëndrojnë të tëra ato akuza se gjëja angazhohet vetëm për të mirën e pozitës. TV “VALI” ka dhënë një kontribut të madh në dobi të qytetarëve tanë dhe gjithmonë i ka përcjell seancat tona dhe i ka pasqyruar ashtu siç janë.

Sa i përket raportit financiar, unë e përshëndes, sepse kjo është një drejtori mjaft e ndjeshme, ka shumë punë dhe sikur t' i pasqyrojnë në detale të gjitha gjërat, atëherë mbledhja do të zgjaste një ose dy javë.

Mirëpo kush do që është i interesuar, drejtori mund t' i jap të dhënat dhe mund t' i shoh detalisht të dhënat. Unë e përgëzoj drejtorin për këtë punë dhe e mbështesë për punë të mëtejme.

Arben Mehmeti- drejtori i di punët e veta dhe nuk ka nevojë askush nga AKR-ja ta udhëzojë se çka duhet bërë drejtori. Mirëpo desha të them se edhe një historian mund të mos e njoh matematikën mirë, por nga ajo që tha kryesuesi 2008 -2011 më duket se janë 4 vjet!

Izmi Zeka- po e them sinqerisht investime kapitale janë 70 milion euro!

Zijadin Maliqi- unë do të përqendrohem në analizën e raportit financiar dhe besoj se do të marrë kohë më shumë. Unë gjatë analizës jam përcaktuar në tri aspekte kryesore si janë: në të hyrat e buxhetit, shpenzimet dhe te investime kapitaledhe te pasqyra e borxheve.

Sa i përket të hyrave vetanke shihet se janë arrit rezultate të mira, sepse shihet në pasqyrat financiare dhe në krahasim me vitin 2010, kemi një rritje prej 12.94%, kurse në krahasim me atë çka është planifikuar kemi një rritje mbi 17%.

Sa i përket pjesës së grandit qëndrojnë pranë asaj se Komuna e Gjilanit nuk trajtohet si duhet dhe këtë bindje nuk mund të ma heq askush derisa në Kuvend nuk sqarohet se si ndahen grandet?

E kam vërejt se një pjesë e mjeteve nga viti paraprak janë bartur në vitin 2011, me përjashtim që janë mbi 63 mijë euro e që janë nga grandit dhe nuk e di pse kanë mbetur (nuk e besoj se janë bartur ato mjete dhe si është vepruar me ato mjete)?

Sa i përket shpenzimeve më tepër jam përqendruar te shpenzimet për mallra dhe shërbime të cilat për mua janë të shumë të mëdha, por sidomos te Administrata Komunale për këtë kategori (shërbime dhe mallra) dhe përfshin 15.2% të shpenzimeve të përgjithshme të kësaj vije buxhetore.

Shëndetësia është në kuadër të normales.

Te Arsimi gjithmonë kam thënë se për mallra dhe shërbime janë ndarë pak mjete dhe shihet nga raporti, sepse ka shpenzime vetëm 7.57% për mallra dhe shërbime. Me atë numër aq të madh të shkollave dhe me mungesë të mjeteve elementare në shkollat tona, këto mjete janë pak për Arsim, kurse te Administrata për mendimin tim janë shumë.

Po i theksoj disa shpenzime nëpër kode;

Kodi 13/100- përfshin shpenzimet e udhëtimit, brenda, jashtë vendit, shpenzimet e akomodimit, mëditjet për udhëtime janë mbi 109 mijë euro. Mendoj se janë shpenzime mjaft të mëdha dhe nuk kemi ndonjë informatë se ku janë bërë këto udhëtime dhe se çka është përfituar nga ato udhëtime?

Kodi 13/300, shërbimet e telekomunikimit, për shpenzimet e telefonisë fikse janë mbi 43 mijë euro, por shpenzim i madh është te “ Vala 900”, sepse janë 32.500 euro.

13/400- shërbimet financiare, nën kodin 13/460 shërbimet kontraktuese të tjera janë mbi 269 mijë euro. Këtu është një shumë e madhe e pasqaruar, për të cilin rast kam kërkuar edhe në raporte periodike sqarime, më është premtuar se do ta keni me shkrim, por asnjëherë nuk kam marrë përgjigje se çka janë këto “shpenzime kontraktuese të tjera” ?

Te nën kodi 13/470, shërbimet teknike është një shumë e madhe, prandaj të na epet një sqarime se çka janë këto shërbime teknike?

13/500, mobile dhe pajisje më pak se 1 mijë euro, por gjithsej shpenzime mbi 105 mijë euro, por përveç tyre janë edhe shpenzime për mobile dhe pajisje prej 1 mijë deri në 5 mijë euro. Këtu ka shpenzime të mëdha e të cilat po përsëriten për çdo vit.

Kodi 13/600 blerje tjera, nën kodi 13/610 furnizim për zyre mbi 234 mijë euro. mendoj se edhe këto janë shpenzime mjaft mëdha.

Kodi 13 /620, ushqim, pije janë 140 mijë 900 euro. Unë e di se janë çerdhet, konvikti, por nëpër disa drejtori të tjera nëse janë ushqim dhe pije për mysafirë, ato ka qenë desh të hynë te kodi tjetër te reprezentacioni.

Kodi 13/700, karburante dhe lëndë djegëse dhe nën kodi 13/780, karburante për vetura është një shumë më e madhe se vitit paraprak mbi 191 mijë euro. Për llogari timen këto shpenzime ka qenë desh të zvogëlohen, sepse janë blerë disa vetura të reja.

Kodi 13/900, shërbimet financiare, nën kodi 13/952, sigurimi i ndërtesave të tjera janë diku mbi 161 mijë euro. Kërkoj një sqarim çka është kjo sigurimi i ndërtesave të tjera?

Kodi 14 mijë, mirëmbajtja, nën kodi 14/010, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve të cilin rast e përmenda se edhe pse janë blerë veturat e reja, përsëri kemi shumë të madhe për riparim të automjeteve!

Kodi 14/100 qiraja 28 mijë e 880 euro. Nuk e dimë se çka paguan Komuna për qira. Nëse paguan a janë zhvilluar procedura për marrje me qira të atyre lokaleve?

Kodi 14/200, shpenzimet e marketingut e që janë edhe me një kod tjetër, kurse këtu janë mbi 55 mijë euro e të cilat janë shumë.

Kodi 14/300 shpenzimet e përfaqësimit, nën kodi 14/310, dreka zyrtare. Edhe vitin e kaluar i kam përmend këto dhe i kam nxjerr edhe për ditë pune dhe më duket se të gjithë u pajtuan se është shumë e madhe e shpenzuar për reprezentacion, por këtë vit janë rrit edhe më tepër. Në këtë kod janë diku mbi 118 mijë euro, ose për ditë pune sa ka qenë 400 euro tash janë rrit në 470 euro.

Këto ishin për mallra dhe shërbime, kurse nga investimet kapitale shihet se një shumë e mjeteve bukur e mirë është shpenzuar për investime kapitale dhe u përmend edhe më parë se një pjesë e shpenzimeve është bërë pjesë-pjesë e të cilat janë projekte të cilat kanë filluar më 2009 dhe 2010, por ende janë të papërfunduara dhe ende nuk kemi një pasqyrë të tyre.

Shihet në raport 2 mijë euro për një pagesë për një shumë të vogël dhe nuk kemi ndonjë pasqyrë më detale për ta ditur.

Sa i përket borxheve, kjo është e keqja më e madhe për mua, sepse shihet se borxhet janë shumë të mëdha për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, sidomos për mallra dhe shërbime. Për këtë kategori janë 925 mijë euro edhe për investime kapitale 1 milion e 541 mijë euro. Në këtë vit me këtë buxhet duhet vetëm të paguajmë borxhe të mëparshme dhe këtë vit nga buxheti i Komunës nuk e shoh se mund të punojmë diçka!

Këto janë obligime që janë pasqyruar në bazë të faturave.

Mirëpo ne nuk e dimë se sa janë obligime të tjera për punë të cilat janë kontraktuar për investime kapitale. Për mua pjesa e borxheve është më shqetësuese, sepse këtu shihet se kemi një shkelje të ligjeve në fuqi. Të Ligjit mbi menaxhimin e financave të Ligjit të prokurimit dhe të Ligjit për buxhetin.

Unë nuk kam si ta aprovoj këtë raport kur e shoh se kemi shkelje të ligjeve në fuqi.

Nuhi Nuhiu- lidhur me atë që e thotë Arben Mehmeti që ne në mënyrë me të detalizuar ta sjellim raportin financiar me detale të shpenzimeve si në mallra dhe shërbime,

subvencione dhe investime kapitale, po e them sinjerisht se po të ishte vetë Arbeni drejtor nuk mund të bënte një gjë të tillë. Nuk mund të sillet në Kuvend e tërë lista e atyre faturave dhe personave, lëvizjeve, drekave, darkave dhe të tëra atyre akomodimeve etj.

Kjo mund të bëhet nëse kërkohet me shkrim nga ana e një grupi parlamentar, por jo për të gjitha, sepse ne nuk jemi të obliguar ta sjellim një raport financiar në këtë formë si e kemi sjell. Ne jemi të obliguar t' i paraqesim pasqyrat financiare, ato të cilat i dërgojmë edhe në ministri dhe në thesar. Se sa kush din t' i lexojë është tjetër pyetje, por për këtë arsye e kemi hartuar raportin në këtë formë. Unë e kam vullnetin t' i përgjigjem secilit grup parlamentar, por kjo është e pamundur, sepse kërkon kohë të gjatë derisa të bëhet lista për çdo shpenzim. Nëse e kërkon në këtë formë, ne këtë mund ta bëjmë në raporte periodike, mund ta sjellim një monitor dhe aty mund ta shohim çdo faturë dhe shpenzim ku është bërë, por seanca do të zgjat dy-tri ditë.

Sa i përket Sokol Hazirit, është lista e investimeve kapitale, por edhe ajo kërkon një punë detale dhe duhet të punohet se deri ku ka mbërri ai investim, sa është kompensuar, sa ka mbet për pa u kompensuar etj?

Ju është mirë t' i bëni kërkesat me shkrim, por jo për çdo gjë duhet t' i bëni për ato gjëra ku është i ndjeshëm buxheti! Ku ju mendoni se mund të keq menaxhohet buxheti, por jo për çdo imtësi.

Unë e jap raportin në bazë të ligjit që më obligon dhe nuk jam i obliguar të jap raport në bazë të asaj që ju po e kërkon! Auditori Gjeneral ka qenë dy muaj këtu dhe ju në këtë Kuvend do ta keni atë raport dhe do ta shihni se si e ka menaxhuar Komuna e Gjilanit buxhetin.

Zijadini duhet ta kuptoj njëherë e përgjithmonë, te çështja e grandit. Grandi ka formulë zotëri këshilltar! Ajo formulë e ka numrin e popullsisë, numrin e nxënësve, territorin etj. Nuk ka mundësi për ta rrit territorin, nuk ka mundësi për ta rrit numrin e nxënësve për ta marrë një grand për nxënës e kështu me radhë.

Për çështje të obligimeve që e tha Zijadini edhe ne e kuptojmë, ligjin e lexojmë, por duhet kuptuar se ky buxhet është buxhet social, buxhet i mbijetesës. Po shihet se 15 milion euro janë për paga dhe mëditje? Mori fund me këtë, nuk ka buxhet për zhvillim ekonomik. Neve na duhet vetëm të angazhohemi, llojshmëri në mënyra të ndryshme për ta sjell ndonjë dhurues ose ndonjë projekt për zhvillim.

Tash po i them edhe disa detale:

13/110 është kodi për shpenzime të udhëtimit brenda vendit, shuma është 50 mijë e 640 euro. Kjo është për transport të nxënësve, klubeve sportive dhe SHKA-ve

13/183- Shpenzime të tjera të udhëtimeve zyrtare brenda vendit, 1.394, transporti i studentëve të Fakultetit të Edukimit, grave shërbyese civile dhe një grup i qytetarëve serbë.

Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit 13/140, 24 mijë e 154 euro, transporti i nxënësve në Turqi, karateistët e në Kampionatin e Gjermanisë dhe disa shërbyes civil.

13/141, mëditjet jashtë vendit, mëditjet e delegacioneve nga Komuna.

13/142, vizitat e punëtorëve në Shqipëri

13/320, shpenzimet telefonike "Vala 900", mbi 32 mijë e 500 euro romingat e dhe kartelat grishëse për zyrtarë.

13/410, shërbimet e arsimit dhe trajnimit, 3274 euro trajnime, trajnimi i punëtorëve

13/460, shërbimet kontraktuese 269 mijë e 400 euro, këtu përfshihen; Shoqata e Zjarrfikësve, mjekët, rrënimi i garazheve pas soliterit, tërheqja e automjeteve me merimangë, vlerësimi i pasurisë së Higjienës, skanimi i dokumentacionit në Kadastër,

kontrata në vepër, organizmi i takimeve promovuese dhe berza e punësimit. Për këtë veprimtari janë harxhuar mbi 269 mijë euro

13/470, shërbimet teknike, 13.632.00 euro, zërimi për manifestime

13/480, shërbimi për anëtarësim, 16.317.00, Asociacioni i Komunave (pagesa e anëtarësimit).

13/501, mobile mbi 21 mijë euro, inventar, teatër, arsim (është blerë inventar për këto institucione).

Pajisje të tjera është një kod në të cilin paraqitet problem, sepse zyrtarët financiar, ndonjëri e deklaroi në pajime të tjera, tjetri në mobile (për këtë arsye bëhen edhe ngatërresa).

Pjesa më e madhe e donacionit 63.154.00 është kabinete nga Banka Botërore, Qeveria Zvicerane për arsimin fillor dhe të mesëm, pajisje për amvisëri për disa qytetarë (minoritete), inventar elektronik për Administratë dhe Inspeksion. Për këto qëllime janë shpenzuar 63.154.00 euro.

13/620, furnizim me ushqim dhe pije, këto janë pako ushqimore për skamnorë dhe ushqim për çerdhe dhe konvikt të nxënësve dhe studentëve, 189 mijë euro.

Akomodimi 6.750.00 (akomodim i mysafirëve në Hotelin “Kristal”, mysafirët e Flakës së Janarit, mysafirët nga Turqia etj.

13/670, municion dhe armë zjarri, 4.800.00, fishekzjarrë për Ditën e Pavarësisë/

13/780, karburantet për vetura (te karburantet 100 e 45 mijë euro janë për transport të nxënësve). Mirëpo edhe 17 mijë 891 janë për Shëndetësi, 7.407.00, janë për Zjarrfikës dhe 65 mijë e 289 janë karburante të cilat i kanë shpenzuar veturat e Qeverisë Komunale.

13/953, siguri e ndërtesave të tjera mbi 160 mijë euro, (për sigurim, roje të objekteve). Kompania që e bën sigurimin e objekteve i ka marrë këto mjete.

Mirëmbajtja e ndërtesave, 51 mijë e 856 euro, pastrimi i objekteve.

Subvencione për entitete publike (partitë politike), mbi 34 mijë euro.

Subvencione për entitete publike, Teatër, Bibliotekë, mbi 64 mijë euro

Subvencione për entitete jo publike mbi 41 mijë euro, OJQ-të dhe SHKA-të.

Për përfitues dhe individ personal janë mbi 129 mijë euro.

Të gjitha këto janë të shtypura me emër dhe mbiemër dhe çdo kush që është i interesuar mund t’i shoh kur të dëshirojë.

Zijadin Maliqi- unë e falënderoj drejtorin për sqarime, por së pari te grandit Qeveritar, unë e di formulën dhe e kam kuptuar mirë, është numri i popullatës, popullata pakicë, numri i nxënësve, territori etj. Mirëpo më intereson pse nuk është sqaruar me kohë se cila është formula për përfitimin e grandeve? Unë edhe më herët e kam thënë në raport me numrin e të punësuarave nuk është në rregull! Nuk është në rregull ose te formula ose te numri i punëtorëve? Unë këtë sqarim po e kërkoj, sepse ka mundësi që dikush ta dijë këtë formulë, por ka mundësi që dikush mos ta dijë?

Tek investimet që u përmenden, unë deputeteve të Kuvendit të Kosovës ia kam thënë të gjitha në atë takimin që patëm në Hotelin “Kristal”. Unë edhe pse jam në opozitë, interesohem shumë për Komunën e Gjilanit, sepse është qytet i imi ku shkollohen dhe rriten fëmijët tanë.

Sa i përket borxheve, ato mos i arsyetoni, sepse arsyetohet një vlerë e borxhit e muajit të dymbëdhjetë, por jo të tjerat. Nuk punohet ashtu prej borxhit në borxh!

Sa i përket gjërave të tjera, unë qëllimisht i thash për ta njoftuar Kuvendin.

Te shërbimet kontraktuese mendoj se është një shumë e madhe dhe e kam ditë që është në Shoqatë e Zjarrfikësve, është një pjesë e mjekëve që paguhen në atë kod, janë një pjesë e punëtorëve me kontratë në vepër, por duhet ditur se këto shoqata a janë marrë me procedura të rregullta të prokurimit? Ne jemi të interesuar t' i punësojmë mjekët, por duhet zbatuar procedurat, mandej nuk e dimë sa është numri i punëtorëve me kontrata etj. Edhe këtu kemi shkelje të ligjit, drejtori duhet ta dijë këtë, është Ligji mbi buxhetin. Unë të falënderoj për shpjegimet e tjera të cilat ia dhe Kuvendit, por ju nuk duhet të prekeni pse ne i kërkojmë këto, sepse kjo i kontribuon transparencës.

Ramiz Ramdani- ne këtu disa jemi këshilltarë (anëtarë të Kuvendit), drejtorë, etj, por para kësaj jemi qytetarë të komunës së Gjilanit dhe çdo rezultat dhe sukses është i përbashkët dhe e gëzon çdo njërin prej neve! U tha nga kryesuesi se në këtë Komunë janë investuar 70 milion euro, mua sinqerisht më gëzoi kjo dhe kisha desh të jetë kështu!

Mirëpo pas kësaj në faqen tjetër po i vërej se 4 milion e 300 mijë euro janë të PPP-së, i cili partneritet është në fazën fillestare. Nuk e kam të qartë sa herë kjo do të prezantohet? Kjo shumë prej 4 milion e 300 mijë euro janë investuar brenda kësaj periudhe 2008-2011, por jam i bindur se në fund të vitit 2012 përsëri do të prezantohet kjo shumë. Kjo nuk na bënë shumë nder, sepse neve na duhet një zhvillim dhe jo një raport sa për mbulesë (kamuflyese)!

Në seancën e fundit drejtori i Bujqësisë e paraqiti një raport të investimeve 2 milion e 200 mijë euro dhe do të isha shumë i lumtur sikur të kishte ndodhur ashtu?

Po të shikohen investimet kapitale në bujqësi janë 12 mijë e 700 euro, drejtori ka mundësi për ta dhënë ndonjë shpjegim. Kërkoj të jeni të saktë, a janë 2. milion e 200 mijë euro, apo 12 mijë e 700 euro?

Unë nuk jam njohës i mirë i ekonomisë, por po kërkohet një kujdes maksimal tek të hyrat vetanake, por në mjetet e bartura të 2010 që janë mbi 436 mijë euro për rroga dhe mëditje paguhen 82 mijë euro? Unë nuk e di se ka të drejtë ose e lejon ligji nga mjetet vetanake të kompensohen mëditjet dhe pagat?

Për mallra dhe shërbime kompensohen 176 mijë euro ose 40% dhe sinqerisht mendoj se është në kundërshtim me ligjin, mirëpo për investime kapitale 92 mijë euro ose 21% !

Drejtori besoj se do të ketë përgjigje për këtë?

Mendoj se shpesh po krijohet ajo bindja se ne si opozitë po jemi tendencioz. Mandej e pashë një shifër shumë të madhe te Drejtoria e Administratës për investime në zyre, kjo mund të kuptohet, sepse mund të jenë 410 zyre, por furnizim për zyre të kryetarit mbi 45 mijë euro, këtë nuk e kuptoj?

Hartimi i projekteve për investime kapitale, nuk po më pengon vlera pre 200 mijë euro, por do të ishte e rrugës ta dimë se cilat janë hartuar?

Mandej në fund donacionet dhe participimet, unë besoj se ndoshta është ndonjë lëshim teknik, sepse për ndryshe nuk është as falënderuese dhe ndoshta fyese, sepse janë prezantuar disa donacione deri në 2 euro dhe 1 euro.

Participuesi kryesor i projekteve në KK, janë bujqit të cilët në fakt e të cilët 12. e 900 e uro kanë participuar në projekte pak më shumë se sa kanë marrë!

Nuhi Nuhiu- së pari u tha se nuk ka të drejtë me ligj të bëhet pagesa e pagave dhe mëditjeve nga mallrat dhe shërbimet, por këto janë për kujdestari në shëndetësi dhe mësimi jo formal në arsim (për këto qëllime e bëjmë pagesën nga ky kod).

Mandej u përmend furnizimi i zyrës te kryetari, por nuk e di a qe keni të qartës se kryetari i ka 37 punëtorë në kuadër të shërbimit të tij? Nga zyra e kryetarit të gjithë

këta zyrtar furnizohen me material dhe me tërë dokumentacioni e nevojshëm. Të gjitha zyrat janë përfshirë nga buxheti i kryetarit dhe nga kjo shihet se nuk është ndonjë shpenzim enormë ashtu siç po mendohet. Të gjitha zyrat të cilat nuk kanë buxhet, si ajo Ligjore e Projekteve etj furnizohen nga Zyra e kryetarit.

Në bujqësi kanë participuar qytetarët me 12 mijë e 870 euro, por në fund e keni totali nga participimi i qytetarëve. Ju faleminderit

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi propozoi që të aprovohet ku raport financiar për vitin fiskal 2011.

Aprovohet pika 2.1 e rendit të punës : Raporti financiar për vitin fiskal 2011 me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 17 ishin kundër.

Me këtë pikë të rendit të punës seanca i përfundoi punimet, në ora 14.30

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA